



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 22 Shkurt 2023

Nr: 62

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS TË BASHKISË PRRENJAS, PËR  
RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES  
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 22 Shkurt 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrative me:

**SUBJEKT:** Z. Maliq Alla, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për bashkinë Prrenjas

**OBJEKT:** Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Prrenjas, për raportimin e veprimtarive publike

**BAZA LIGJORE:** Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**K O N S T A T O J :**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 06.02.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin e 2 (dy) veprimtarive publike të kryera nga bashkia Prrenjas, të cilat rezultojnë të paraportuara në ndërfaqen e dedikuar për këtë qëllim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Indicia është marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

Data: 22 Shkurt 2023

Nr: 62

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit ndaj bashkisë Prrenjas, në kuadër të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

1. “Në kuadër të 100 vjetorit të krijimit të Shërbimit Pyjor në Shqipëri, bashkia Prrenjas në bashkëpunim me Skuadrën Vullnetare e të Rinjve kontribuan në shtimin e sipërfaqes së gjelbërta duke mbjellë fidanë pishë në zonën e Rezervuarit të Prrenjasit”.

Link:<https://www.facebook.com/photo/?fbid=551391727036350&set=pcb.551401193702070>

2. “Kishim kënaqësinë që të mirëprisnim në bibliotekën e qytetit tonë Z. Koçi Tahiri. Disa nga botimet dhe librat e tij u dhuruan për bibliotekën e qytetit Prrenjas”.

Link:<https://www.facebook.com/photo/?fbid=613870980745358&set=pcb.613875394078250>

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht çështjen, vlerësoi se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Më datë 9.2.2023, bashkisë Prrenjas i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 10.2.2023, ora 10:59 AM, bashkia Prrenjas bën me dije se: “...Në vijim të email-it tuaj datë 9.2.2023 me objekt: “Kërkesë për informacion, bashkia Prrenjas”, ju informojmë si më poshtë:

**Së pari**, bashkia Prrenjas, në datë 30 Janar 2023, ora 1:45 (PM), është identifikuar si përdorues për raportimet e veprimtarive publike në adresën [xhambazimatilda88@gmail.com](mailto:xhambazimatilda88@gmail.com) (bashkangjitur emaili i konfirmimit), për këtë arsye bashkia Prrenjas nuk ka raportuar këto 2 (dy) veprimtari publike në ndërfaqen e KQZ-së.

**Së dyti**, në lidhje me informacionin e kërkuar nga ana juaj për dy aktivitetet sipas link-eve përkatëse (të dërguar nga ana juaj), ju informojmë se:

Aktiviteti i pare, është zhvilluar më datë 27 Janar 2023; Ora 12:30; Organizatori: bashkia Prrenjas; Tematika e aktivitetit: Në kuadër të 100- vjetorit të krijimit të Shërbimit Pyjor në Shqipëri; Pjesëmarrja: Ekipi i Vullnetare të të Rinjve, Punonjës të Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave pranë Bashkisë Prrenjas; Mediatizimi: I hapur për mediat (nuk ka patur pjesëmarrës nga mediat).

*Aktiviteti i dytë, është zhvilluar më: Datë 21 Janar 2023; Ora 11:00; Organizatori: bashkia Prrenjas; Tematika e aktivitetit: Pasurimi i bibliotekës së Qytetit Prrenjas; Pjesëmarrja: Kryetari i Bashkisë Prrenjas z. Nuri Belba, z.Koçi Tahiri - Shkrimtar, - z. Medi Hana-Drejtori i Zyrës Vendore Arsimore Prrenjas, znj.Albina Rira- Drejtor i Drejtorisë së Arsimit pranë Bashkisë Prrenjas si dhe ka patur pjesëmarrje nga qytetarë; Mediatizimi: I hapur për mediat (nuk ka patur pjesëmarrës nga mediat)”.*

Pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerësoj se problematikat me sistemin dhe kredencialet kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive jashtë vullnetit të organit publik.

Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësoj se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrativ për ato shkelje që lidhen me çështjen objekt shqyrtimi.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

#### **V E N D O S :**

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj z. Maliq Alla, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në bashkinë Prrenjas.
2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Tërheqje vëmendje ndaj bashkisë Prrenjas, për marrjen e masave të menjëhershme, për raportimin e veprimtarive publike.
4. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 22 Shkurt 2023

Nr: 62  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit ndaj bashkisë Prrenjas, në kuadër të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”